



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Numri i Çështjes	31155-01804-80-2020	Data e Regjistrimit	5/31/2020
Numri i Vendimit	80-2020-1740	Data e Vendimit	8/31/2020

### VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

#### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane E PERBERE NGA:

**KRYESUES:** Avni Sejdi

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Griselda Doresi

**Objekti:** Shfuqizimin e vendimit nr. 44, date 02.04.2020 " Per trajtimin e perkohshem financiar mujor te deputeteve te Kuvendit te Shqiperise gjate periudhes se gjendjes se epidemise se shkaktuar nga covid-19", te Byrose se Kuvendit te Shqiperise Detyrimi i Kuvendit te Shqiperise, te na paguaje te gjitha perfitimet financiare qe burojne nga legjislacioni per "Statusin e Deputetit" qe lidhen me ushtrimin e funksionit, per periudhen Mars 2020- Maj 2020 me page neto te plote. Detyrimi i pales se paditur Kuvendi i Shqiperise qe ne perputhje me "Statusin e Deputetit" te beje korrigjimet perkatese ne librezet e punes dhe ate te kontributeve shoqerore.

**Baza Ligjore :** Nenet 31,32, 154 te K.Pr.Civile, ligji 8550, dt.1 8.11.1999 "Statusi i Deputetit", i ndryshuar, ligjin Nr. 10160, dt. 15.10.2009 "Per rregullimin e sherbimit te transportit per funksionaret publike dhe nenpunesit civil", Vendimi nr.68, dt.20.02.2003 "Per menyren e trajtimit te deputeteve" dhe vendimin nr.20, dt.10.12.2009 "Per percaktimin e mases se perfitimit financiar' mujor per shperblimin e transportit te deputeteve" Nenet 7, 11,15, 17/1/a e vijues te Ligjit Nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative

**Përmbledhja e vendimit:**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 44, datë 02.04.2020 Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19", të Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë.
2. Detyrimi i Kuvendit të Shqipërisë, të na paguajë të gjitha përfitimet financiare që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën Mars 2020-Maj 2020 me pagë neto të plotë.
3. Detyrimi i palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë që në përputhje me "Statusin e Deputetit" të bëjë korrigjimet përkatëse në librezën e punës dhe atë të kontributeve shoqërore.

Paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi i janë drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar sipas objektit.

Gjykata, referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë, në mbështetje të nenit 7, shkronja "a" 10/1, dhe 11/1 të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" i ndryshuar, dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, kryesisht konstaton se, është kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështje dhe se mosmarrëveshja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Për të bërë të mundur përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit në këtë gjykim, në zbatim të nenin 79/a të K.Pr.Civile, kërkesëpadia dhe aktet iu njoftuan Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila ndonëse u njoftua rregullisht për çdo seancë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqit.

Bazuar në nenin 34 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" i ndryshuar, gjykimi u zhvillua në mungesë të palëve ndërgjyqëse, pasi këta të fundit, ndonëse kishin dijeni rregullisht për ditën dhe orën e gjykimit, pa ndojë shkak të arsyeshëm nuk u paraqitën.

- **Rrethanat e çështjes:**

Paditësi Myslim Murrizi është deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Zv/Kryetar i këtij Kuvendi në Legjislaturën e IX. Sipas vërtetimit të lëshuar



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

nga Kuvendi i Shqipërisë, paditësi Myslim Murrizi paguhet me një pagë mujore “bruto” në shumën 187.610 lekë dhe pagë mujore “neto” në shumën 139.896 lekë në muaj.

Edhe paditësi Artur Roshi është deputet në Kuvendin e Shqipërisë që prej datës 23.04.2019, kur me Vendimin Nr. 185 datë 23.04.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka vendosur t'i japë atij mandatin e deputetit si kandidat i radhës në listën shumëemërore të Partisë Demokratike, Qarku Tiranë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë, paditësi Artur Roshi paguhet me një pagë mujore “bruto” në shumën 157.660 lekë dhe pagë mujore “neto” në shumën 117.891 lekë në muaj.

Me vendimin Nr. 44 datë 02.04.2020 “Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19” Byroja e Kuvendit ka vendosur:

*I. Deputetët gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se 3 muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.*

*II. Efektet financiare sipas pikës 1 fillojnë prej muajit Mars 2020.*

*III. Derdhja në buxhetin e shtetit e shumave të papaguara bëhet në bankën e nivelit të dytë Credins Bank fondi anticCOVID-19, i miratuar për vitin 2020, me numër llogarie në lekë nr. 1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.*

*IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.*

*V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e palës së paditur, paditësi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi duke kërkuar sipas objektit.

- **Pretendimet e palëve**

**Paditësit:**

Nëpërmjet parashtrimeve të pasqyruara në kërkesëpadi nga pala paditëse në mënyrë të përmbledhur është pretenduar si më poshtë:

1. Pagesa mujore është fikse e miratuar si përfitim financiar në bazë të statusit që gëzojmë si deputet dhe se pala e paditur, Kuvendi i Shqipërisë, është i detyruar t'i zbatojë këto detyrime. Për shkak edhe të kësaj veprimtarie si deputet na njihen ligjërisht të drejtat financiare lidhur



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

me pagën mujore. Si rrjedhojë përfitimi me pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale që pala e paditur ka vendosur, është i padrejtë dhe kërkimi jonë për të detyruar palën e paditur të na paguajë ato është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe si i tillë duhet pranuar. Përfitimi mujor duhet të jetë në masën 100% të pagës mujore, pagesë fikse e miratuar si përfitim financiar, sipas statusit të deputetit dhe se Kuvendi është i detyruar t'i paguajë ato.

2. Ushtrimi i mandatit parlamentar mundet të bëhet sipas mënyrave të ndryshme dhe se aktiviteti parlamentar mundet të ushtrohet si në seancë plenare, në komision apo edhe jashtë parlamentit. Gjithashtu Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit kanë parashikuar edhe struktura organizative politike brenda Kuvendit, sikur janë grupet parlamentare etj. Në rastin konkret Byroja Kuvendit në mënyrë të njëanshme ka vendosur që Deputetët gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se 3 muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale, duke mos marrë në konsideratë faktin që pagesa është fikse e miratuar si përfitim financiar, sipas statusit të deputetit. Çështja e pagës së deputetit dhe e shpërblimeve të tjera të tij nuk duhen parë dhe kuptuar thjesht konform regjimit juridik të Kodit të Punës, duke dhënë shpërblim në masën 50% të pagës mujore neto aktuale gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Trajtimi financiar i deputetëve duhet shtruar dhe kuptuar si një problem në aspektin kushtetues të statusit të deputetit. Ndaj shpërblimi për pagën dhe përfitimet e tjera duhen parë si pjesë e pandashme e mandatit të deputetit, të cilët i përfitojnë këto pavarësisht periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Kjo mënyrë e interpretimit dhe kuptimit kushtetues të mandatit parlamentar të deputetit rrjedh nga garancitë që Kushtetuta ka dhënë për përfaqësimin në Kuvend.

3. Kështu nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës. Në një situatë të tillë deputeti nuk do të ishte në gjendje të sillte në parlament, aty ku formohet dhe shprehet vullneti politik i zgjedhësve, përvojën, bindjet dhe aftësitë e tij me qëllim qeverisjen sa më të mirë të vendit. Në këtë rast gjen zbatim parimi se çdo deputet është i rëndësishëm individualisht dhe si i tillë përbën një element të pandashëm nga tërësia e parlamentit. Ndaj mandati nuk mundet të cenohet apo të preket në të gjitha dhe në secilin prej elementeve që Kushtetuta dhe ligji parashikojnë për statusin e deputetit.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

#### Pala e paditur:

Nëpërmjet prapësimeve depozituara në sekretarinë gjyqësore, pala e paditur Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur prapësoi kërkimet e palës paditëse si më poshtë:

1. Kuvendi vë në dukje se vetë vendimi objekt gjykimi i Byrosë së Kuvendit nr. 44 datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19" nuk është marrë në kushte të zakonshme, por është në kushtet e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19, fakt ky i njohur botërisht. Gjithashtu marrja e këtij vendimi është paraprirë nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë së Kuvendit, ku rezultoi se ka marrë mbështetjen e të gjithë anëtarëve të tij, përfshirë edhe të njërit prej paditësve i pranishëm në mbledhje, z. Myslim Murrizi - Zëvendëskryetar i Kuvendit.

2. Referuar procesverbalit të mbledhjes, rezultoi se projektvendimi objekt shqyrtimi u është njoftuar paraprakisht në rrugë elektronike deputetëve nga shërbimet e Kuvendit dhe qëllimi i tij ka qenë kontribuimi financiar nga të gjithë deputetët për të ndihmuar financiarisht në përballimin e situatës së krijuar. Në mbledhjen e Byrosë rezultoi se asnjë nga deputetët nuk ka shprehur kundërshti apo mosdakordësi në lidhje me kontribuimin financiar, por përkundrazi e kanë mbështetur fort këtë nismë duke e vlerësuar maksimalisht si një veprim i duhur që duhej ndërmarrë nën përgjegjshmërinë e tyre si përfaqësues të popullit. Gjatë diskutimit në këtë mbledhje, është vërtetë se z. Murrizi ka shprehur objeksionin e tij dhe ka kërkuar shpjegime për mënyrën e mbledhjes së këtyre fondeve, por në asnjë moment nuk ka kundërshtuar apo refuzuar dhënien e kontributit financiar nga ana e tij, çka përbën edhe vetë thelbin e vendimit të marrë nga Byroja. Madje siç rezultoi nga procesverbali i mbledhjes, z. Murrizi ka shprehur gatishmërinë e tij për të kontribuar financiarisht edhe më shumë sesa masa prej 50% e propozuar nga Kryetari i Kuvendit. Pas sqarimit të dhënë nga Kryetari i Kuvendit lidhur me kompetencën dhe bazën ligjore për marrjen e këtij vendimi, mbledhja ka vijuar normalisht duke konkluduar me vendimmarrjen e pasqyruar në vendimin nr. 44 datë 02.04.2020, për të cilën asnjë nga anëtarët e Byrosë të pranishëm në mbledhje, përfshirë z. Murrizi, nuk e kanë kundërshtuar vendimin.

3. Mbledhja e këtyre fondeve është një akt solidariteti i shprehur me vullnetin e secilit prej anëtarëve të Kuvendit, për të ndihmuar sadopak në përballimin e situatës së krijuar dhe nga ana tjetër vendimi i Byrosë së Kuvendit në këtë rast është vetëm një formalizmi i këtij vullneti, duke e materializuar atë me qëllim bërjen efektive të mbledhjes së fondeve dhe



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

shmangien e burokracive e vonesave te panevojshme, në rast se secili prej deputeteve do t'i kryente individualisht procedurat për derdhjen e kontributit pranë bankave apo zyrave te financës pranë Kuvendit. Ajo çfarë është më e rëndësishme në këtë proces, është fakti se nuk kemi të bëjmë aspak me deformim apo imponim të vullnetit të asnjë prej anëtarëve të Kuvendit, pasi askush prej tyre nuk e ka kundërshtuar në asnjë formë propozimin për të kontribuar financiarisht me 50% të pagës, por e përsërisim që kemi të bëjmë vetëm me formalizim të këtij vullneti.

4. Vendimi i Byrosë së Kuvendit nr. 44 datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjate periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19" në pikën 1 të tij përcakton në mënyrë të qartë vetëm ndalesën prej 50% të pagës mujore neto për periudhën e pandemisë, por jo më shumë se 3 (tre) muaj, dhe nuk ka të bëjë aspak me ndalesa të tjera për të cilat paditësit pretendojnë se u janë cenuar. Ju konfirmojmë se asnjëri prej deputetëve të Kuvendit, përfshirë paditësve z. Murrizi dhe z. Roshi nuk u është cenuar asnjë e drejtë financiare që ata përfitojnë nga statusi i deputetit si dhe nuk rezulton të jetë bërë nga administrata e Kuvendit asnjë shënim/ndryshim në librezat e tyre përkatëse të punës apo të kontributeve shoqërore, sikundër kërkohet prej tyre që të bëhen korrigjime.

- **Vlerësimi i gjykatës:**

#### **Në lidhje me plotësimin e kushteve formale të padisë:**

Një nga kushtet formale të paraqitjes së padisë në gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative është ajo e ezaurimit të rrugës administrative të ankimit, si dhe ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

Sipas **nenit 129 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në RSH"**, ligj ky që ishte në fuqi në kohën e refuzimit të kryerjes së veprimit administrativ, objekt gjykimi "*Shterimi i ankimit administrativ, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative, përveç rasteve kur*"

- a) ligji nuk ka parashikuar organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;*
- b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t`u ankuar drejtpërdrejt në gjykatë;*
- c) organi më i lartë në shqyrtimin e ankimit administrativ ka cënuar, me*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*vendimin e tij të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedurën administrative.*

Po ashtu, i njëjti parashikim ligjor, është parashikuar edhe në ligjin e posaçëm nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar i cili në nenin 16 pika 1 të tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykatës.

Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

Në lidhje me shterimin ose jo të ankimit administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr.1 datë 26.11.2010, kanë arritur në përfundimin unifikues sipas të cilit: "**Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t'i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhënien juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hirarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ**".

Ligji i posaçëm nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit" i ndryshuar, i cili rregullon marrëdhëniet financiare ndërmjet deputetit dhe Kuvendit të Shqipërisë, dhe që gjendet i zbatueshëm në çështjen objekt shqyrtimi gjyqësorë, në asnjë dipsozitë të tij nuk ka parashikuar ndonjë mundësi konkrete ankimi ndaj vendimeve të Byrosë së Kuvendit për cënimin e pagës së deputetit, si dhe nuk ka parashikuar organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ.

Në analizë të sa më sipër dhe duke u bazuar dhe në arsyetimin e Kolegjeve të Bashkuara, në vendimin unifikues nr. 1, datë 26.11.2010,



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Gjykata, vlerëson se, për sa kohë në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit" i ndryshuar, nuk është parashikuar ndjekja e një procedure të detyrueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, paditësi ka të drejtë që të rivendosë të drejtat e tij të shkelura, duke ju drejtuar direkt juridiksionit gjyqësor.

Në këto kushte, paditësi ka të drejtë që t'i drejtohet direkt gjykatës nëpërmjet padisë si mjet i vetëm procedural, nëpërmjet të cilës të mund të rivendosë në vend të drejtat e tij, të pretenduara si të shkelura nga pala e paditur. *Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi (neni 31 i K.Pr.Civile).*

Në këto rrethana, gjykata çmon se ka juridiksion që të vendosë për shqyrtimin e kësaj çështje.

#### **Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë:**

Ashtu siç u citua më sipër, kusht tjetër formal për paraqitjen e padisë, është ai i respektimit të afatit të paraqitjes së padisë.

**Në nenin 18 pika 1 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar (Afati për ngritjen e padisë)** thuhet se:

*1. Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve.*

#### **Ky afat fillon nga:**

*a) data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ të organit epror, që ka shqyrtuar ankimin administrativ;*

*2. Afati i mësipërm është 1 vit, në rastet kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë. Në rastin e mosparaqitjes së padisë brenda 1 viti, për arsye se udhëzimet në aktin administrativ nuk japin informacion të saktë për të drejtën e padisë, padia paraqitet edhe pas 1 viti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data kur paditësi ka marrë dijeni për ekzistencën e së drejtës së padisë dhe vetëm kur paditësi jep shpjegime të besueshme për këto rrethana në padinë e tij.*

Në lidhje me afatet e parashkrimit legjislacioni ynë parashikon dy kategori të afateve të parashkrimit; **afate të përgjithshme dhe afate të posaçme**, ku afatet e përgjithshme janë më të gjata se afatet e posaçme.





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Afatet e përgjithshme të parashkrimit zbatohen për të gjitha kërkesat që i shtrohen parashkrimit shues, kur për këto nuk është caktuar në ligj një afat i posaçëm parashkrimi.

Ligji i posaçëm nr. 8550, datë 18.11.1999 "*Statusi i deputetit*" i ndryshuar, nuk ka parashikuar ndonjë afat të posaçëm në lidhje me paraqitjen e ankimit në gjykatë, kundër vendimit Byrosë së Kuvendit për cënimin e pagës.

Po ashtu, edhe akt administrativ objekt kundërshtimi gjyqësor, Vendimi i Byrosë së Kuvendit Nr. 44 datë 02.04.2020 "*Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19*" nuk ka përcaktuar në mënyrë konkrete të drejtën e ankimit dhe afatin e ngritjes së padisë

Sipas pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" i ndryshuar, të sipërcituar, kur akti administrativ nuk tregon qartë për të drejtën dhe afatin e padisë, ky afat është 1 vit.

Duke qenë se si ligji organik nr. 8550/1999, ashtu dhe akti administrativ objekt gjykimi, nuk kanë përcaktuar si të drejtën e ankimit ashtu dhe afatin e paraqitjes së padisë në gjykatë, kundër vendimit të Byrosë së Kuvendit për cënimin e pagës së deputetit, gjen zbatim afati i përgjithshëm i paraqitjes së padisë të parashikuar nga neni 18, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, e që është 1 vit, nga data e njoftimit të aktit.

Referuar rastit në gjykim, rezulton se akti administrativ (Vendimi i Byrosë së Kuvendit nr.44 datë 02.04.2020 "*Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19*") është nxjerrë në datën 02.04.2020 dhe sipas pikës V, ka hyrë në fuqi menjëherë, pra në datën e nxjerrjes së këtij akti, **ndërsa kërkesëpadia është depozituar në gjykatë më datë 13.05.2020, pra brenda afatit 1-vjeçar të përcaktuar në pikën 2 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar.**

Sa më sipër, gjykata konstaton se padia e paraqitur nga pala paditëse plotëson kushtet formale për t'u marrë në shqyrtim nga ana e gjykatës.

#### **Në lidhje me legjitimimin e palëve:**

**Sipas nenit 32/a të K.Pr.Civile, padia mund të ngrihet:**

- a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*është shkelur.*

Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Kështu, sipas nenit 15 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;

Në kuptim të këtyre dispozitave procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (**legjitimim aktiv**) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mohon ose shkel të drejtën e kërkuesit (**legjitimim pasiv**).

Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr. 49/2012, e kondicionon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të cënuar prej dikujt tjetër.

Referuar provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore rezulton se me vendimin Nr. 44 datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19" Byroja e Kuvendit ka vendosur:

I. Deputetët gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se 3 muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

II. Efektet financiare sipas pikës 1 fillojnë prej muajit Mars 2020.

III. Derdhja në buxhetin e shtetit e shumave të papaguara bëhet në bankën e nivelit të dytë Credins Bank fondi anticOVID-19, i miratuar për vitin 2020, me numër llogarie në lekë nr. 1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sa më sipër, bazuar në nenin 32/a të K.Pr.Civile, si nenit 15/a të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar, paditësit legjitimohen për t'iu drejtuar me padi gjykatës për të kërkuar rivendosjen e së drejtës së tyre të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur, pasi akti administrativ i sipërcituar, ka cënuar drejtpërdrejt interesat e tyre pasurore që rrjedhin nga statusi i deputetit.

Po ashtu, pala e paditur Kuvendi i Shqipërisë ka legjitimitet pasiv në këtë gjykim, pasi është pikërisht ky organ i cili nëpërmjet vendimit Nr. 44 datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19" ka proceduar me ndalesën e pagës së paditësve, gjatë kohës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Nga sa më sipër, si paditësi ashtu dhe pala e paditur, kanë legjitimitet aktiv dhe pasiv në këtë gjykim.

#### **Në lidhje me themelin e çështjes:**

Në lidhje me sa u pretendua nga ana e palëve në këtë gjykim, gjykata, referuar rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore si dhe shkakut ligjorë të padisë, çmon se kërkimet e palës paditëse janë të bazuara në ligj dhe se kërkesëpapia e paraqitur prej saj duhet pranuar, duke arsyetuar si më poshtë:

Ashtu siç u citua më sipër, paditësi Myslim Murrizi është deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Zv/Kryetar i këtij Kuvendi në Legjislaturën e IX. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë, paditësi Myslim Murrizi paguhet me një pagë mujore "bruto" në shumën 187.610 lekë dhe pagë mujore "neto" në shumën 139.896 lekë në muaj.

Edhe paditësi Artur Roshi është deputet në Kuvendin e Shqipërisë që prej datës 23.04.2019, kur me Vendimin Nr. 185 datë 23.04.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t'i japë atij mandatin e deputetit si kandidat i radhës në listën shumëemërore të Partisë Demokratike, Qarku Tiranë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Kuvendi i Shqipërisë, paditësi Artur Roshi paguhet me një pagë mujore "bruto" në shumën 157.660 lekë dhe pagë mujore "neto" në shumën 117.891 lekë në muaj.

Me vendimin Nr. 44 datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

*mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19* Byroja e Kuvendit ka vendosur:

VI. *Deputetët gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se 3 muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.*

VII. *Efektet financiare sipas pikës 1 fillojnë prej muajit Mars 2020.*

VIII. *Derdhja në buxhetin e shtetit e shumave të papaguara bëhet në bankën e nivelit të dytë Credins Bank fondi anticCOVID-19, i miratuar për vitin 2020, me numër llogarie në lekë nr. 1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.*

IX. *Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.*

X. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

Marrëdhëniet financiare ndërmjet deputetit dhe Kuvendit të Shqipërisë rregullohen me ligjin e posaçëm nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit" i ndryshuar.

Sipas pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit" i ndryshuar, paga e deputetit përbëhet nga paga për pjesëmarrjen e tij në seancë, në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare.

Ndërsa, në pikën 5 të nenit 13 të ligjit të sipërpërmendur është përcaktuar se: ***"Mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura e deputetit në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare sjell ndalesën e pagës ditore."***

Nga përmbajtja e dispozitës ligjore të sipërcituar, i vetmi rast i cënimit të pagës së deputetit është mospjesëmarrja pa shkaqe të përligjura në seancë, në komisione ose në veprimtari të tjera parlamentare.

Pyetja që shtrohet para gjykatës është: A konsiderohet shkak i përligjur gjendja e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19?

Në lidhje me këtë pyetje të shtruar për zgjidhje, gjykata thekson se mandati i deputetit është individual dhe përgjegjësia mbi sjelljen e gjithsecilit mbi këtë mandat shihet rast pas rasti dhe nuk mund të justifikohet me sjellje kolektive.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Në lidhje me dhënia e kontributit financiar, me qëllim përballimin dhe lehtësimin e situatës së rëndë ekonomike të shkaktuar nga COVID-19, mbi bazën e të cilës është miratuar Vendimi nr.44, datë 02.04.2020 i Byrosë së Kuvendit, Gjykata, vleron se ky është një akt i vullnetëshëm dhe jo i detyruar.

Në rastin konkret, ndalesa e pjeshme në masën 50% të pagës mujore neto për paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi është bërë në kundërshtim me ligjin pasi situata e rëndë ekonomike e shkaktuar nga COVID-19, nuk përbën shkak të përligjur për cënimin e pagës së deputetit, pasi sikurse u theksua më sipër, dhënia e kontributit financiar me qëllim përballimin dhe lehtësimin e kësaj situatë është një akt i vullnetëshëm dhe jo i detyruar.

Sipas nenit 28 të ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 "*Statusi i deputetit*" i ndryshuar, **të drejtat që përfitojnë deputetët nga ky ligj, nuk mund të cenohen.**

Për sa më sipër, gjykata çmon se akti administrativ, Vendimi Nr. 44 datë 02.04.2020 "*Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19*" i Byrosë së Kuvendit, për pjesën që ka cënuar pagën e paditësit Myslim Murrizi dhe Ardit Roshi, është akt administrativ i paligjshëm pasi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit material nr. 8550 datë 18.11.1999 "*Statusi i Deputetit*" i ndryshuar, çka e bën këtë akt të paligjshëm në kuptim të nenit 109 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*" në të cilin thuhet se: **Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:**

**a) është në kundërshtim me ligjin material;**

Me konstatimin e paligjshmërisë së aktit administrativ, gjykata është e detyruar që të shprehet edhe për rregullimin e pasojave të krijuara nga kjo paligjshmëri, pasoja këto të kërkuara edhe nga paditësit në objektin e kërkesëpadisë, konkretisht detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë, që t'u paguajë paditësve të gjitha përfitimet financiare që burojnë nga legjislacioni për "*Statusin e Deputetit*" që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën Mars 2020-Maj 2020 me page neto të plotë dhe të bëjë korrigjimet përkatëse në librezën e punës dhe atë të kontributeve shoqërore.

Përfundimisht, nga sa u analizua më sipër, gjykata çmon se kërkesëpadia e paraqitur nga paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi, duhet pranuar tërësisht duke vendosur si më poshtë:



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

1. Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 44, datë 02.04.2020 "Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19", të Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë, për pjesën që i ka cenuar pagën paditësve Myslim Murrizi dhe Artur Roshi.
2. Detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë, që tu paguajë paditësve Myslim Murrizi dhe Artur Roshi të gjitha përfitimet financiare që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën Mars 2020-Maj 2020, me pagë neto të plotë.
3. Detyrimi i palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë që në përputhje me "Statusin e Deputetit" të bëjë korrigjimet përkatëse në librezën e punës dhe atë të kontributeve shoqërore për paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi.

Gjithashtu, në dhënien e vendimit përfundimtar, gjykata ka detyrimin ligjor për tu shprehur në lidhje me shpenzimet gjyqësore të kryera nga palët gjatë gjykimit.

**Sipas nenit 106 të K.Pr.Civile**, *taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe shpërblimi për një avokat, n.q.s ka pasur të tillë, të paguara nga paditësi, i ngarkohen të paditurit në masën e pjesës së padisë që është pranuar nga gjykata.*

Ndër shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësit janë: taksa e regjistrimit të padisë në shumën 3.000 lekë, shpenzime këto që në bazë të dispozitës procedurale civile të sipërcituar i duhen ngarkuar palës së paditur.

**Për keto arsye:**

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306 të K.Pr.Civile, nenin 40/1, gërma "a", të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të ndryshuar.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata Administrative e Shkalles se pare Tirane

Vendosi:

- Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi.
- Shfuqizimin e pjesshëm të vendimit nr. 44, datë 02.04.2020 *"Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19"*, të Byrosë së Kuvendit të Shqipërisë, për pjesën që i ka cenuar pagën paditësve Myslim Murrizi dhe Artur Roshi.
- Detyrimin e palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë, që t'u paguajë paditësve Myslim Murrizi dhe Artur Roshi të gjitha përfitimet financiare që burojnë nga legjislacioni për "Statusin e Deputetit" dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit, për periudhën Mars 2020-Maj 2020 me pagë të plotë.
- Detyrimi i palës së paditur Kuvendi i Shqipërisë që në përputhje me "Statusin e Deputetit" të bëjë korrigjimet përkatëse në librezën e punës dhe atë të kontributeve shoqërore për paditësit Myslim Murrizi dhe Artur Roshi.
- Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësit në masën 3.000 (tre mijë) lekë, lihen në ngarkim palës së paditur.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv në zbatim të nenit 510/a të K. Pr. Civile dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarrimit shtetëror/privat, nga data që ky vendim merr formë të prerë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall në Tiranë sot me datë 27.07.2020.

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.